



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 926 Prot.

Tiranë, më 27.06 2019

VENDIM Nr. 169, datë 25.06.2019

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", Neni 48 dhe VKM Nr. 786, datë 26.12.2018 "Për miratimin e zonave arkeologjike "A" dhe "B", të qytetit të Durrësit dhe të Planit për Ruajtjen, Mbrojtjen dhe Administrimin e tyre" Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 8, datë 25.06.2019, pasi shqyrtoi kërkesën për miratim të projektit "Hotel 3-4 kat (Rikonstruksion +shtesë kati dhe shtesë anësore në objekt ekzistues 1 kat) rruga "Glaukia", zonë arkeologjike "B" Durrës-subjekti Z. Bashkim Stafhasani, relacionin për pritshmërinë arkeologjike dhe konceptin e realizimit të sondazhit arkeologjik për zonën ku zhvillohet projekti, paraqitur nga subjekt i licencuar në arkeologji, Z. Eduard Shehi,

VENDOSI:

1. Të miratojë relacionin për pritshmërinë arkeologjike dhe konceptin e realizimit të sondazhit arkeologjik për zonën ku zhvillohet projekti, paraqitur nga subjekt i licencuar në arkeologji, Z. Eduard Shehi.
2. Subjekti Z. Bashkim Stafhasani duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili do të realizojë sondazhin arkeologjik, si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë subjekt. Raporti i tij do të paraqitet në KKA e radhës.
3. Investitori Z. Bashkim Stafhasani duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
4. Investitori Z. Bashkim Stafhasani si dhe subjekti i licencuar në arkeologji, i cili do të kryejë sondazhin arkeologjik, në mbështetje të legjislacionit në fuqi dhe akt-marrëveshjes tre palëshe të sipërcituar, janë të detyruar të marrin të gjitha masat për sigurimin dhe ruajtjen e kantierit, si dhe ruajtjen e strukturave arkeologjike, të cilat mund të zbulohen gjatë kryerjes së sondazhit arkeologjik, deri në vendimmarrjen përfundimtare të KKA, në lidhje me to.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

**KRYETAR
ELVA MARGARITI
MINISTËR**



**SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO**

